



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE
TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL TË KOSOVËS PËR
VITIN 2022**

Prishtinë, maj 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës (AAC), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të AAC kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjisllacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm që të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 2 rekomandime të reja.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje në vitin 2022 ishte 764,719€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 30 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 28. Kemi testuar 22 mostra për teste substanciale në vlerë 37,799€ ku kemi hasur si në vijim:

Çështja A1 - Pagesë e pagave të punonjësve për pozita specifike të pa aprovuara/pa miratuara për nivelin e pagës dhe pagesë me të lartë sesa miratimi

Gjetja

Ligji nr. 03/L-051 neni 24.2 Drejtori i Përgjithshëm mundet, pas shqyrtimit dhe miratimit nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave, tani e tutje Ministria Financave Punës dhe Transfereve , të përcaktojë një nivel të rrogave për anëtarët e personelit profesional të AAC-së i cili i kompenson secilin nga këta anëtarë të personelit profesional, në një shkallë që është në përputhje me (i) nivelin e aftësisë të dëshmuar të tij/saj, (ii) cilësinë e arsimimit të tij/saj, (iii) nivelin e arritjeve arsimore, dhe (iv) përvojën dhe njohurinë e dëshmuar të tij/saj. Gjatë përcaktimit të nivelit të rrogave duhet të merret parasysh kompensimi i pozitave në industrinë e aviacionit civil për të cilat pozita kërkohet aftësi, arsimim, njohuri dhe përvojë të ngjashme. Vendimi i ministrit të financave i datës: 20/03/2009 dhe vendimi i datës: 25/03/2010.

Kemi hasur në nëntë (9) raste për pozita me titujt specifik të punës të kontraktuar që nuk kishin miratim të pagës nga ministri, përkundër kësaj në një rast ishte paguar punonjësi për pozitën asistent i logjistikës më tepër për 3,000€ në vit sesa miratimi i ministrit të financave i datës 25/03/2010 e që ishte si rezultat i vendimit të drejtorit të përgjithshëm në prill të vitit 2012.

Kjo ka ndodhur si rezultat që AAC nuk e kishte dërguar te ministri kërkesën për miratim të nivelit të pagave për pozitat specifike të punonjësve dhe këto pozita i ka sistemuar/paguar në aprovimet e pozitave specifike tjera të aprovuara.

Ndikimi

Mos miratimi i nivelit të pagave për pozita specifike si rezultat i mos dërgimit të kërkesës nga AAC për miratim mund të ndikoj në nivelin jo të duhur të ekuivalencës për pozitat specifike të punës dhe pagesa me e lartë sesa aprovimi ndikon në mbi pagesë.

Rekomandimi A1

Drejtori i Përgjithshëm të sigurojë, që të gjitha pozitat kanë marrë miratimin sipas legjislacionit në fuqi si dhe të ndër marrë masa që të gjithë punonjësit të marrin pagën në bazë të nivelit të miratuar të pagave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera neto e paraqitur në PVF e pasurive kapitale është 10,548€, e pasurive jo kapitale është 10,558€, si dhe e stoqeve 2,674€. Kemi testuar pesë (5) mostra për teste substanciale në vlerë neto 1,720€, ku kemi hasur si në vijim:

Çështja A2 - Mos regjistrimi i pasurive jo kapitale në sistemin e-pasuria.

- Gjetja** Rregullorja 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive të Organizatave Buxhetore, neni 6 paragrafi 3 Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.
- Pasuritë jo kapitale nën 1,000€ dhe stoqet nuk janë regjistruar në sistemin e-pasuria. Përkundër kësaj AAC ka regjistër të brendshëm në Excel, nga i cili bënë shpalosjen e tyre në pasqyra financiare.
- Kjo ka ndodhur për shkak të angazhimit jo të mjaftueshëm të zyrtarëve përgjegjës të pasurisë në regjistrimin e tyre në këtë sistem.
- Ndikimi** Mos evidentimi i pasurive jo kapitale dhe stoqeve në sistemin e-pasuria, ndikon në një menaxhim jo efektiv të pasurisë dhe stoqeve si dhe menaxhmenti nuk mund t'i ketë informatat/raportet në kohë reale për këto pasuri.
- Rekomandimi A2** Drejtori i përgjithshëm duhet të sigurojë, që zyrtarët përgjegjës të bëjnë regjistrimin e pasurive jo kapitale dhe stoqeve në sistemin e-pasuria.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final ⁵ | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet | 2020 Shpenzimet |
|-----------------------------|-------------------|----------------------------|-----------------|-----------------|-----------------|
| Burimet e fondeve | 1,004,947 | 896,375 | 750,068 | 876,303 | 854,870 |
| Grante Qeveritare - Buxheti | 1,004,947 | 890,447 | 750,068 | 876,303 | 854,870 |
| Donacionet e jashtme | 0 | 5,928 | 0 | 0 | 0 |

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 108,572€. Kjo ulje është rezultat i zvogëlimit të investimeve kapitale në vlerë 96,500€ dhe mallra e shërbimeve në vlerë 12,072€.

Në vitin 2022 AAC ka shpenzuar 84% të buxhetit përfundimtar ose 750,068€, me një ulje 14% në krahasim me vitin 2021. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të pakënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet | 2020 Shpenzimet |
|--|-------------------|----------------|-----------------|-----------------|-----------------|
| Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike | 1,004,947 | 896,375 | 750,068 | 876,303 | 854,870 |
| Pagat dhe mëditjet | 764,719 | 764,719 | 693,109 | 768,117 | 731,088 |
| Mallrat dhe shërbimet | 140,728 | 128,656 | 56,377 | 106,378 | 118,174 |
| Komunalitë | 3,000 | 3,000 | 582 | 1,808 | 5,608 |
| Investimet Kapitale | 96,500 | 0 | 0 | 0 | 0 |

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti fillestar i investimeve kapitale ishte deklaruar si kursim përmes vendimeve qeverisë, si pasojë e mos realizimit të projekteve kapitale të AAC-së;
- Buxheti i pagave dhe mëditjeve për 764,719€ ishte realizuar në vlerë 693,109€ apo në përqindje 91%; dhe
- Buxheti i shërbimeve u zvogëlua me 12,072€ përmes deklarimeve si kursime nga vendimet e qeverisë.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e realizuara nga AAC në 2022 ishin në vlerë 2,899,912. Ato kanë të bëjnë me taksën e sigurisë së udhëtarëve dhe taksa/tarifa tjera të vendosura nga AAC-ja.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2022 Pranimet | 2021 Pranimet | 2020 Pranimet |
|---------------------------|-------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| Totali i të hyrave | 2,240,515 | 2,240,515 | 2,899,912 | 2,054,903 | 1,254,484 |
| Të hyrat jo tatimore | 2,240,515 | 2,240,515 | 2,899,912 | 2,054,903 | 1,254,484 |

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 nuk kishte rekomandime për përmirësim.


Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm




Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Hysen Boqolli, Udhëheqës i ekipit



Fatbardha Jashari, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



| | | | |
|---|--------------|------------------------|--|
| Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo | | | |
| Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës / Autoriteti Çështjeje Aviativore Kosovë / Civil Aviation Authority of Kosovo | | | |
| CAA | | | |
| Nr. i prot. / Prot. No. 2023/202/155 | | | |
| Str./prot./Prot. No. | | | |
| Faqe / Pages | Kopje / Copy | Data / Date 12.05.2023 | |
| Hyrtje / Attachment | | | |
| Drejtuesi / Director | | | |
| Brendshëm / Internal | | | |
| Prishtinë / Pristina / Prishtina | | | |

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Bujar Ejupi

Drejtor i Përgjithshëm

Data: 12.05.2023

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.